



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gramatikë e aplikuar e gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare

Viti / Semestri Viti I / Semestri 1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “PËRKTHIM DHE INTERPRETIM NË GJUHËN RUSE”

Kodi i etikës : Kodi i etikës i Ut-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kursi është konceptuar në bazë të metodologjisë ndërvepruese dhe të pjesëmarrjes. Sistemi i ushtrimeve ndërtohet sipas përvetësimit të shprehive dhe aftësive ligjërimore. Ushtrimet praktike që përforcojnë materialin e marrë gjatë orëve të tjera të mësimi të gjuhës dhe shkojnë krahas me to, bëjnë që studenti të riprodhojë saktë dhe më me lehtësi shprehjet e fituara. Çdo kapitull krahas përdorimit të elementit gramatikor në ushtrime, ushtron edhe kompetencën ligjërimore nëpërmjet interpretimit të përzgjedhjes së tij, dhe në fund diktimi bazuar po në aplikimin e konceptit gramatikor.

Në përfundim të modulit studenti duhet të jetë i aftë:

- të ngulisë, të përthithë e përvetësojë rregullat dhe aplikimin e tyre në ligjërim.
- të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyetojë mbi gabimet e bëra duke i vlerësuar dhe korrigjuar nga vetë ai.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë:

- në lakimin e emrit, përdorimin e tij me folje të ndryshme në bazë të kuptimit të tyre gramatikor.
- të përdorë saktë format gramatikore si në ligjërimin e folur ashtu edhe në të shkruar, por për të pasur një nuhatje gjuhësore pa qenë nevoja e sjelljes ndërmend të një rregulli të caktuar, duke u mbështetur në aftësitë e krijuara gjatë ushtrimit të kompetencës gramatikore praktike.